



02Nr 6457 /2023
04.08.2023

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 , ,Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125 neni 1 pika 1.20 dhe neni 69 pika 1.11,Udhëzimin Administrativ(MSH) Nr.02/2015 Organizimi,përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësorë neni 14 Komuna Hani Elezit shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni:**Komuna Hani Elezit**

Drejtoria:**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Titulli i vendit të punës: Infermier/e

njësia/ sektori:**Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare“Dr.Menduh Kaloshi”Hani i Elezit,**

Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**

Titulli i mbikëqyrësit: **Drejtori i QKMF-së**

Koeficienti/Grada: **H-17 ose H-20**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë: Sipas Qarkores Informative 02/2017 e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë

- Siguron mbrojtje primare shëndetësore .
- Cakton,planifikon implementon dhe vlerëson kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët .
- Të administron terapinë e përshkruar në përputhje me politikën institucionale.
- Tu ofron pacientëve informata të qarta lidhur me kujdesin i cili u ofrohet atyre.
- Të përdorë dhe mirëmban në mënyrë të sigurt të gjitha pajisjet .
- Të merr pjesë në mbledhjet e ekipit kur është e nevojshme.
- Të ruan konfidencialitetin e plotë për çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit dhe punën e institucionit .
- Të kryen dhe detyra tjera që kërkohen nga mbykqirësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë .

Dokumentet e nevojshme:


- Dëshminë për shkollimin e mbaruar në Infermieri (e vërtetuar).
- Licenca e Punës (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën që nuk është nën Hetime.
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit).
- Certifikatën që dëshmon njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera e dëshirueshme .
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 04.09.2023 deri 18.09.2023 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëprehen aplikacionet e femrave dhe meshkujve të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

M. Ballazhi